



Pranimi / Dorezimi Prilaps / Prilaps Acceptance / Delivery		17.01	2022	2	viti / god. Year
Organ / Agjencia Organ / Agency Org / Unit	Id / Prot Id / Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix		Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHCK	191/2022			1/4	

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A nr.942/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani –anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.942/2021 të datës 18.11.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë: kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**PËRFUNDON PROCEDIMI** administrativ lidhur me ankesën A.nr.942/2021 të datës 18.11.2021 të parashtruar nga ankuesja

**A r s y e t i m**

Komuna e Prishtinës, me datë 13.10.2021 ka shpallur konkursin me nr. reference RNOOOO7659 për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë”, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila pretendon se nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, por ju ka nënshtruar testimin që është mbajtur me datën 04.11.2021, mirëpo nuk është përzgjedhur si kandidat e suksesshëm për këtë pozitë.

Më datën 12.11.2021 Komuna e Prishtinës ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm me 89% të pikëve për pozitën “Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë”.

E pakënaqur me procedurën e rekrutimit lidhur me testin me shkrim me datën 08.11.2021 përmes e-mailit zyrtar ka parashtruar kërkesë nga Burimet njerëzore në Komunën e Prishtinës por nuk ka marrë përgjigje nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës.

Ankuesja e pakënaqur për mos përgjigje nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, më datë 18.11.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 5511/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 19.11.2021, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Komuna e Prishtinës më datë 03.12.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me shkresat e procedurës së zhvilluar me provat e bashkangjitura të lëndës dhe është protokolluar me numër. 5801/2021.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën e datës 18.11.2021 me numër protokolli 5511/2021 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 10.11.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës; Kopja e konkursit e datës 13.10.2021-20.10.2021 për pozitën Udhëheqës i Sektorit të Shëndetësisë; e-mail i datës 01.12.2021 me kërkesë vendimin e komisionit vlerësues; E-mail i 30.11.2021; Vendimi i datës 10.11.2021 me nr.14-070/01-242465/21 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Komunës së Prishtinës; Fletëkthesa e datës 24.11.2021; Kopja e konkursit e datës 25.07.2019; Njoftim i datës 05.09.2019; kopja e konkursit e shpallur me datën 02.07.2020; Njoftim i datës 01.10.2020; E-mail i datës 25.06.2021; Njoftim i datës 25.10.2021; Njoftim i datës 12.11.2021; Njoftim i datës 12.11.2021 i vlerësuesit të komisionit; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 28.01.2021 për ; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 07.02.2020; Aplikacioni për Diploma e Fakultetit të Mjekësisë i datës 30.03.2006; Diploma master e datës 15.11.2018 e kolegjit Iliria; Çertifikatë e datës 08.09.2021; Çertifikatë e datës 29.04.2021; Çertifikatë e datës 22-23.04.2021; Çertifikatë e datës 19, 20.04.2021; Çertifikatë e datës 18.19.03.2021; Çertifikatë e datës 08.09.2021; Çertifikatë e datës 23-24.02.2021; Çertifikatë e datës 27-28.01.2021; Çertifikatë e datës 08.04.2021; Çertifikatë e datës 10.11.2020; Çertifikatë e datës 26.05.2017; Çertifikatë e datës 23.10.2015; Çertifikatë e datës 01.10.2015; Çertifikatë e datës 05.05.2011, Pasqyra e llogarisë së trustit për Marrëveshje për shërbime të veçanta prej datës 20.04.2017 deri më datën 19.10.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta prej datës 02.11.2017; Marrëveshje për shërbime të veçanta prej datës 30.04.2018; Marrëveshje për shërbime të veçanta prej datës 15.10.2018; Marrëveshje për shërbime të veçanta prej datës 13.05.2018; Vendimi i datës 26.08.2019 me nr.14-112/01-208355/19 i Komunës së Prishtinës; Akt emërimi i datës 08.07.2020 me nr.01nr.112-1161; Letër reference e datës 24.01.2020; CV për Diploma e datës 13.11.2019 nr.59/18 e lëshuar nga kolegji Iliria për Konfirmim i datës 29.09.2021 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim ; Diploma e datës 01.10.2015 për e lëshuar nga kolegji Universum; Diplomë e datës 30.09.2019 për e lëshuar nga kolegji AAB; Licencë e punës e datës 02.07.2020 e lëshuar nga oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës; Licencë e punës e datës 10.01.2018 e lëshuar nga oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës; Diplomë e datës 10.06.2003; Referencë e datës 23.07.2019; Referencë e datës 29.05.2012; Referencë e datës 15.07.2013; Letër reference e datës 30.07.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë e datës 31.12.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2020; Formulari për vlerësimin e punës provuese i datës 08.07.2021; Akt emërimi i datës 12.07.2021; Vërtetim i datës 16.09.2021; Vendim për caktimin e ushtruesit të detyrës i datës 14.09.2021; Kontratë pune e datës 28.12.2012; Marrëveshje për Shërbime të veçanta e datës 01.08.2019; Çertifikatë e datës 05.12.2014; Çertifikatë e muajit shtator-tetor 2017; Çertifikatë e muajit maj-qershor 2018; Çertifikatë e muajit nëntor-dhjetor 2017; Çertifikatë e datës 08.07.2016;



Çertifikatë e datës 17.06.2011; Çertifikatë e datës 05.02.2021; Çertifikatë e datës 06.10.2017; Çertifikatë e datës 27.09.2011 dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 03.12.2021 me numër protokoli 5801/2021 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses znj *është e pa lejuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankueses me nr. A.nr.942/2021 të datës 18.11.2021 ka konstatuar se lidhur me ankesën e ankueses, Këshilli ka pranuar me datën 10.01.2022 një kërkesë përmes e-mailit zyrtar me nr. protokoli 40/2022e cila kërkon që të tërheq ankesën A.nr.942/2021 të datës 18.11.2021, Arsyeja e tërheqjes është ruajtja e marrëdhënieve kolegiale dhe profesionale.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se pas e-mailit zyrtar të datës 10.01.2022 nga ankuesja për tërheqje të ankesës, andaj mbi bazë të kësaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që të vendoset për përfundim të procedimit administrativ, ashtu siç parashihet me nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*.

Andaj, bazuar në këto rrethana, e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, vendosi që ankesa e parashtruar nga ankuesja të përfundohej procedimi administrativ.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda me A.nr.942/2021, 17.01.2022

Sabile AVDYLI

*Sabile Avdyli*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet**

- Ankueses,
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

